100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË



# EKONOMIA DHE BUXHETI

*KORRIK, 2012*

# *Raporti Mujor*

## *Korrik 2012*

*Kontakt:*
*Telefon: ++355 (4) 228 1009*
*e-mail: elami@minfin.gov.al*

www.minfin.gov.al

# PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE ........................................................................ 2

ZHVILLIMET EKONOMIKE ........................................................................ 3

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit 3
2. Kursi mesatar i këmbimit 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave 5
4. Bilanci i Pagesave 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar 7
6. Kredia për Ekonominë 7
7. Oferta e Parasë 8
8. Depozitat sipas Burimeve 9

SEKTORI FISKAL........................................................................ 10

1. Buxheti i Konsoliduar 10
2. Të Ardhurat sipas Burimeve 11

ANEKSI STATISTIKOR........................................................................ 12

# VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin korrik, 2012 arriti në 112.0 përqind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin korrik ishte 2.7 përqind;
- *Kursi mesatar i këmbimit* të monedhes vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin korrik 2012 ishte 111.77 lekë për dollarë dhe 137.46 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit korrik shënuan kuotat 6.68 përqind për depozitat 24 mujore, 5.33 për ato 12 mujore, 4.34 për 6 mujorët dhe 3.82 perqind per depozitat 3 mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 10.91 përqind për huatë 12 mujore dhe 11.78 për ato 6 mujore;
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 1,101.2 miliardë lekë në muajin korrik, duke shënuar një rritje prej rreth 8.4 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave* për vitin gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej 10.7 milion euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën Janar - korrik 2012 rezultoi me një defiçit të përgjithshëm prej rreth 21 miliardë lekë;
- *Të ardhurat gjithsej* të realizuara gjatë periudhës janar - korrik 2012, arritën në rreth 190 miliardë lekë, ose rreth 94.6 përqind e planit për periudhën;
- *Shpenzimet gjithsej* gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 211 miliardë lekë, ose rreth 99.7 përqind e shpenzimeve të planifikuara për periudhën;

# ZHVILLIMET EKONOMIKE

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin korrik 2012 pësoi një rënie prej -0.2 përqind krahasuar me muajin qershor ‘12, kur ky indeks shënonte -0.8 përqind, ndërsa gjatë muajit maj ’12 ky indeks ishte -0.8 përqind. Ndryshimet respektive në të njëjtët muaj të një viti më parë ishin -0.7 përqind, -1.1 përqind dhe -1.1 përqind. Rënia me e madhe mujore, gjatë muajit korrik u konstatua në grupin “Veshje dhe Këpucë” me -0.8 përqind. Pesha specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte minimale mbi normën e inflacionit.

Graf - 1




***Ndryshimet mujore të IÇK-së***

Burimi: INSTAT

Norma vjetore e inflacionit në muajin korrik arriti në 2.7 përqind duke qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2011 dhe 2012 paraqiten në tabelën 1.

Tab - 1 *Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)*

| *VITI* | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***2011*** | 3.3 | 4.5 | 4.3 | 4.1 | 4.2 | 3.9 |
| ***2012*** | 1.6 | 0.6 | 1.0 | 1.6 | 1.9 | 2.2 |
| *VITI* | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
| ***2011*** | 3.6 | 3.1 | 2.8 | 3.0 | 2.9 | 1.7 |
| ***2012*** | 2.7 | | | | | |

*Burimi: INSTAT*

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt Euros në muajin korrik 2012, arriti në 137.46 Lekë/Euro, duke shënuar një rënie të lehtë prej -0.8 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit korrik një euro u këmbye me 137.31 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin korrik 2012, arriti në 111.77 lekë/dollarë duke shënuar një rritje prej 1.2 përqind kundrejt muajit qershor '12.

Në fund të muajit korrik, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 111.95 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin korrik të vitit të kaluar rezulton se monedha shqiptare është zhvlerësuar ndaj dollarit amerikan në masën 13.3 përqind dhe është vlerësuar kundrejt monedhës europiane, Euro, me 3.2 përqind. Nënçmimi dhe mbiçmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, në rradhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rënie mesatare duke arritur në rreth 1.230 euro/dollarë.

Graf - 2




*Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit korrik '12*

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtjen e ritmeve pozitive të ekonomisë në vend, efikasitet te politkës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

# 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit korrik 2012, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 5.33 përqind, duke shënuar një rritje prej 0.17 përqind krahasuar me muajin qershor. Rënie për këtë muaj kanë pësuar edhe depozitat me afatet e maturimit 6, 3 dhe 1-mujore të krahasuara me muajin paraardhës. Rëniet respektive ishin me 0.04 përqind, 0.03 përqind dhe 0.01 përqind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar normat e interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit 12, 6, 3 dhe 1-mujore.

Graf - 3




*Normat e interesit për depozitat*

Graf - 4




*Normat e interesit për huatë*

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit korrik pësoi një rënie me 0.19 pikë përqindje, duke arritur në 10.91 përqind nga 11.10 përqind që ishte në muajin qershor. Për këtë muaj norma e interesit të huave 6-mujore pësuan një rritje prej 1 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin korrik arriti në 11.78 përqind.

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit korrik 2012, për bonot me maturim 12 dhe 6 mujore ishin përkatësisht 7.34 përqind, 6.24. Gjatë këtij muaji vihet re një rënie e lehtë në Yield-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12 – mujore dhe 6-mujore me respektivisht 0.03 dhe 0.01 pikë përqindje.

# 4. Bilanci i Pagesave

Graf - 5




***Bilanci i Pagesave***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Bilanci i pagesave për periudhën janar – qershor 2012 regjistroi nje suficit të përgjithshëm prej 10.7 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në grafikun 5.

Graf - 6




***Llogaria Korente***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i deficitit të llogarisë korente prej 446.0 milion euro i shprehur sipas elementëve kryesorë përbërës (ne terma neto) për periudhën janar'12 - qershor'12 rezultoi: *(i)* bilanci tregtar -941.2 mln euro, *(ii)* shërbime neto 37.2 mln euro, *(iii)* të ardhura neto -17.1 mln euro, (iv) transferta neto 475.1 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet ne grafikun 6.

# 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit korrik 2012, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 40,542.8 milionë lekë krahasuar me fund vitin 2011. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes të mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 9,605.8 milionë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 30,937 milionë lekë. Në muajin korrik sistemi bankar rezulton me një rritje prej 16,767.4 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin qershor '12, rritje e cila erdhi si rezultat i rritjes së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 10,373.2 milionë lekë si dhe të rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë, me rreth 6,394.2 milionë lekë.

Graf - 7




Burimi: Banka e Shqipërisë

# 6. Kredia për Ekonominë

Teprica e kredisë për ekonominë për muajin korrik 2012 arriti në 552.7 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me fund vitin 2011 shënoi vlerën 10.8 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 2.0 përqind. Nga struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 63.6 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 351.5 miliardë lekë.
Këtë muaj pesha specifike e kredive për individët, arriti në nivelin 26.9 përqind.

# 7. Oferta e Parasë

Graf-8




***Agregati M3 Korr '11- Korr '12***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin korrik ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës qershor 2012. Kjo ofertë arriti në rreth 1,101 miliardë lekë në fund të muajit korrik duke shënuar një rritje prej 8.6 miliardë lekë kundrejt nivelit të rregjistruar në muajin qershor'12. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 8.4 përqind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar.

Graf-9




***Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rritje prej 17.4 miliardë lekë në krahasim me muajin Dhjetor 2011.

Graf-10




***Raporti i Depozitave ndaj M3***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë gjatë muajit korrik, janë mbështetur kryesisht nga depozitat e sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 86.2 përqind të depozitave totale në valutë.

# 8. Depozitat sipas Burimeve

Graf - 11




*Përberja e depozitave*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit korrik 2012, zëri "sektorë të tjerë rezident", zuri nivelin më të lartë të depozitave të trasferueshme në lekë, me rreth 63.5 përqind, ndjekur nga "korporata të tjera jofinanciare", me rreth 23.9 përqind dhe nga "korporata publike jofinanciare", me 9.8 përqind. "Sektorë të tjerë rezident" dhe "korporata të tjera jofinanciare" ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, përkatësisht me rreth 86.2 përqind dhe rreth 11.3 përqind. "Sektorë të tjerë rezident" ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i Depozitave të tjera në lekë (95.9 përqind e totalit)

Në përgjithësi, "Sektorë të tjerë rezident" përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 806 miliarde) të depozitave totale, prej rreth 913 miliardë lekë në muajin korrik 2012. Ata ndiqen nga "korporata të tjera jofinanciare" (79.8 miliardë), "korporatat të tjera jofinanciare publike" (15.7 miliardë) dhe "korporata të tjera financiare" (9.7 miliardë). "Qeveria lokale" kontribuoi me rreth 1.8 miliardë në totalin e depozitave.

Gjatë muajit korrik 2012, krahasuar me një muaj më parë qershor 2012, niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 7.8 miliardë lekë, si rezultat i rritjes së depozitave në lekë dhe të atyre në valutë.

# SEKTORI FISKAL

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar - korrik 2012 janë mbledhur rreth 190 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 211 miliardë lekë, që përfshijnë 179.3 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 31.7 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 54.3 % financim i brëndshëm, dhe 45.7 % financim i huaj.

Graf - 12




*Treguesit Fiskal, Janar-Korrik 2012*

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 53.4 % të të ardhurave buxhetore për planin e vitit 2012, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 53.2 % të buxhetit të planifikuar. Shpenzimet korrente janë rreth 55.6 % e planifikimit vjetor të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 45.4 % e planifikimit të tij vjetor.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 131.4 miliardë lekë (ose rreth 36.9 % e Të Ardhurave Totale Vjetore të planifikuara dhe 52.3 % e planifikimit të tij vjetor), të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 7.5 miliardë lekë (2.1 % e Të Ardhurave Totale Vjetore të planifikuara dhe 51.1 % e planifikimit të tij vjetor), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 34.2 miliardë lekë (9.6 % e të ardhurave totale vjetore të planifikuara dhe 57.5 % e planifikimit të tij vjetor), dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin e 15.3 miliardë lekë (4.3 % e të ardhurave vjetore të planifikuara dhe 74 % e planifikimit të tij vjetor). Nga totali i shpenzimeve korrente prej 179.3 miliardë lekë, 39.6 miliardë lekë (22.1 % e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 22.8 miliardë lekë (12.7 %) për interesat, 21.3 miliardë lekë (11.9 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 906 milionë lekë (0.5 %) për subvencione, 66.6 miliardë lekë (37.2 %) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore dhe 15.3 miliardë lekë (8.5 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 12.7 miliardë lekë (7.1 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 10 % (shpenzime personeli), 5.7 % (shpenzime për interesat), 5.4 % (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 0.2 % (subvencione), 16.8 % (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 3.8 dhe 3.2 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt buxhetit të planifikuar vjetor. Shpenzimet kapitale me financim të

brëndshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 24.7 % të shpenzimeve kapitale totale të parashikuara vjetore, ndërsa financimi i huaj është 20.7 %.

## 2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar - korrik 2012 ishin rreth 190 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 173.1 miliardë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 15.3 miliardë.

Tab - 2 *Të ardhurat e realizuara në janar - korrik 2012*

| Burimi | Miliardë Lekë |
|---|---|
| TVSH | 64.6 |
| Tatimi mbi fitimin | 9.9 |
| Taksa doganore | 3.4 |
| Taksat nacionale | 16.6 |
| Akcizat | 21.1 |

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Defiçiti prej 21 miliardë lekë, për periudhën janar - korrik 2012, u mbështet në vlerën 12 miliardë lekë nga burime të brëndshme dhe 9 miliardë lekë me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brëndshëm, ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për muajin korrik 2012, disa nga treguesit kryesorë fiskal ishin:

- Realizimi i Të Ardhurave në masën 28.352 miliardë lekë.
- Realizimi i Shpenzimeve në masën 28.263 miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për muajin korrik, kontributin kryesorë e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat të cilat kapin shifrën e 20.5 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 25.5 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 2.8 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

| | Mujor (Monthly ) | | | | | Mesatar Mujor (Monthly Average) | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Muaji | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | **2012** | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | **2012** | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | **2012** | Month |
| Janar | 0.5 | 0.4 | 0.9 | 0.8 | 0.7 | 0.50 | 0.40 | 1.00 | 0.80 | 0.70 | 3.0 | 2.1 | 3.6 | 3.3 | 1.6 | January |
| Shkurt | 1.0 | 0.7 | 1.1 | 2.3 | 1.3 | 0.75 | 0.55 | 1.02 | 1.55 | 1.00 | 3.6 | 1.9 | 4.7 | 4.5 | 0.6 | February |
| Mars | 0.9 | 0.6 | 0.1 | -0.1 | 0.4 | 0.80 | 0.57 | 0.71 | 1.00 | 0.80 | 4.6 | 1.6 | 4.1 | 4.3 | 1.0 | March |
| Prill | -0.4 | -0.1 | -0.4 | -0.6 | -0.1 | 0.50 | 0.40 | 0.42 | 0.60 | 0.58 | 4.4 | 1.9 | 3.7 | 4.1 | 1.6 | April |
| Maj | -1.0 | -0.8 | -1.2 | -1.1 | -0.8 | 0.20 | 0.16 | 0.10 | 0.26 | 0.30 | 4.2 | 2.1 | 3.3 | 4.2 | 1.9 | May |
| Qershor | -0.8 | -0.6 | -0.7 | -1.1 | -0.8 | 0.03 | 0.03 | -0.04 | 0.04 | 0.12 | 4.0 | 2.3 | 3.2 | 3.9 | 2.2 | June |
| Korrik | -0.6 | -0.7 | -0.5 | -0.7 | -0.2 | -0.06 | -0.07 | -0.10 | -0.07 | -0.03 | 3.7 | 2.2 | 3.4 | 3.6 | 2.7 | July |
| Gusht | 0.6 | 0.7 | 0.8 | 0.3 | | 0.03 | 0.03 | 0.01 | -0.02 | | 2.5 | 2.2 | 3.5 | 3.1 | | August |
| Shtator | 1.1 | 0.8 | 0.7 | 0.4 | | 0.14 | 0.11 | 0.09 | 0.02 | | 2.7 | 2.0 | 3.4 | 2.8 | | September |
| Tetor | 0.1 | 0.4 | 0.2 | 0.4 | | 0.14 | 0.14 | 0.10 | 0.06 | | 2.8 | 2.3 | 3.0 | 3.0 | | October |
| Nëntor | -0.1 | 0.4 | 0.2 | 0.1 | | 0.12 | 0.16 | 0.11 | 0.06 | | 2.6 | 2.8 | 2.8 | 2.9 | | November |
| Dhjetor | 0.9 | 1.6 | 2.2 | 1.0 | | 0.18 | 0.28 | 0.28 | 0.14 | | 2.2 | 3.7 | 3.4 | 1.7 | | December |

*Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë* *Source : INSTAT,Bank of Albania*

Tab - 2 **Kursi i kembimit**

Exchange rate

Leke per njesi te monedhes se huaj *(Leke per unit of foreign currency)*

| Monedha | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | | | | | | | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Jan | Feb | Mar | Apr | May | Jun | Jul | |
| *Mesatarja e periudhes* | | | | | | | | | | | | *Average of period* |
| USD | 83.89 | 94.98 | 103.94 | 105.59 | 107.10 | 105.32 | 105.97 | 106.35 | 108.96 | 110.48 | 111.77 | USD |
| EURO | 122.80 | 132.06 | 137.79 | 139.46 | 138.32 | 139.35 | 140.03 | 139.98 | 139.44 | 138.51 | 137.46 | EURO |
| *Fundi i periudhes* | | | | | | | | | | | | *In the end of period* |
| USD | 87.91 | 95.81 | 104.00 | 105.82 | 105.30 | 104.12 | 105.20 | 106.04 | 111.92 | 109.86 | 111.95 | USD |
| EURO | 123.80 | 137.96 | 138.77 | 139.68 | 138.93 | 140.08 | 140.38 | 140.33 | 139.09 | 138.17 | 137.31 | EURO |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 3

**Normat e interesit me baze vjetore**

Annual Interest Rates

| | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ne perqindje | | | | | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | **Korrik** | In percent |
| **Norma e depozitave** | | | | | | | | | | | | **Deposits rates** |
| 12-M | 6.93 | 6.78 | 6.07 | 6.07 | 5.80 | 5.62 | 5.68 | 5.57 | 5.70 | 5.50 | 5.33 | 12-M |
| 6-M | 5.72 | 5.74 | 5.16 | 5.16 | 4.76 | 4.61 | 4.59 | 4.54 | 4.63 | 4.38 | 4.34 | 6-M |
| 3-M | 5.13 | 5.05 | 4.42 | 4.42 | 4.16 | 3.98 | 3.84 | 3.90 | 3.85 | 3.79 | 3.82 | 3-M |
| 1-M | 4.30 | 4.56 | 4.70 | 4.70 | 3.99 | 3.80 | 3.74 | 3.34 | 3.60 | 3.31 | 3.30 | 1-M |
| **Norma e huase** | | | | | | | | | | | | **Lending rates** |
| 12-M | 11.75 | 12.46 | 11.52 | 11.52 | 10.72 | 11.53 | 11.87 | 10.52 | 11.45 | 11.10 | 10.91 | 12-M |
| 6-M | 12.85 | 12.54 | 11.69 | 11.69 | 11.14 | 9.91 | 12.68 | 11.33 | 11.28 | 10.78 | 11.78 | 6-M |
| **Norma e letrave me vlere** | | | | | | | | | | | | **Securities rates** |
| Bono thesari 1/ | | | | | | | | | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | 6.27 | 6.30 | 5.29 | 5.29 | ... | 5.08 | 5.29 | ... | 5.30 | 5.26 | .... | 3-M |
| 6-M | 7.45 | 7.52 | 6.41 | 6.41 | 6.23 | 6.10 | 6.20 | 6.20 | 6.20 | 6.25 | 6.24 | 6-M |
| 12-M | 8.56 | 9.14 | 7.09 | 7.09 | 7.07 | 7.11 | 7.33 | 7.35 | 7.36 | 7.37 | 7.34 | 12-M |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 4 **TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2012**

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2012

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke (in million leks)*

| Nr. | E M E R T I M I | Janar January | Shkurt February | Mars Mar | Prill Apr | Maj May | Qershor Jun | Korrik Jul | ITEM | No. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **TOTALI TE ARDHURAVE** | **25,731** | **49,277** | **78,348** | **106,314** | **133,162** | **161,574** | **189,926** | **TOTAL REVENUE** | |
| **I.** | **Ndihma** | **345** | **425** | **656** | **747** | **1,356** | **1,552** | **1,621** | **Grants** | **I.** |
| **II.** | **Te ardhura tatimore** | **23,079** | **44,955** | **72,219** | **97,509** | **121,425** | **146,112** | **173,059** | **Tax Revenue** | **II.** |
| **II.1** | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **16,655** | **33,453** | **54,367** | **71,989** | **91,005** | **110,856** | **131,393** | **From tax offices and customs** | **II.1** |
| 1 | Tatimi mbi Vleren e Shtuar | 8,427 | 17,045 | 26,484 | 35,372 | 45,163 | 54,730 | 64,567 | V. A. T | 1 |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 1,011 | 2,070 | 4,993 | 6,348 | 7,688 | 8,787 | 9,867 | Profit Tax | 2 |
| 3 | Akcizat | 2,317 | 4,996 | 7,649 | 10,363 | 13,543 | 17,125 | 21,113 | Excise Tax | 3 |
| 4 | Tatimi mbi te Ardhurat Personale | 2,474 | 4,512 | 6,821 | 8,982 | 11,030 | 13,079 | 15,788 | Personal Income Tax | 4 |
| 5 | Taksa Nacionale dhe te tjera | 2,014 | 3,983 | 7,073 | 9,151 | 11,275 | 14,263 | 16,615 | National Taxes and others | 5 |
| 6 | Taksa Doganore | 412 | 847 | 1,347 | 1,773 | 2,306 | 2,872 | 3,443 | Custom Duties | 6 |
| **II.2** | **Te ardhura nga Pushteti Lokal** | **813** | **1,584** | **2,837** | **5,077** | **5,762** | **6,429** | **7,469** | **Revenues from Local Gov.** | **II.2** |
| 1 | Tatimi mbi pasurine | 136 | 333 | 688 | 1,233 | 1,418 | 1,631 | 1,812 | Tax on land | 1 |
| 2 | Tatimi mbi Biznesin e vogel | 247 | 306 | 490 | 1,039 | 1,103 | 1,141 | 1,502 | Small Business Tax | 2 |
| 3 | Taksa lokale | 430 | 945 | 1,659 | 2,805 | 3,241 | 3,657 | 4,155 | Local Taxes | 3 |
| **II.3** | **Te ardh Buxh. Pavarur** | **5,611** | **9,918** | **15,015** | **20,443** | **24,658** | **28,827** | 34,197 | **Social ins** | **II.3** |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 4,622 | 8,464 | 12,641 | 17,256 | 20,825 | 24,487 | 29,171 | Social Insurance | 1 |
| 2 | Sigurimi Shendetsor | 897 | 1,306 | 1,800 | 2,571 | 3,142 | 3,590 | 4,204 | Health insurance | 2 |
| 3 | Te ardhura per kompensim ne vlere te pronareve | 92 | 148 | 574 | 616 | 691 | 750 | 822 | | |
| **III.** | **Te ardhura Jotatimore** | **2,307** | **3,897** | **5,473** | **8,058** | **10,381** | **13,910** | **15,246** | **Nontax Revenue** | **III.** |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise | 170 | 470 | 770 | 2,143 | 2,543 | 2,843 | 3,143 | Profit transfer from BOA | 1 |
| 2 | Te ardhura nga Inst.Buxhetore | 1,385 | 2,147 | 2,898 | 3,427 | 4,067 | 4,613 | 5,076 | Income of budgetary institutions | 2 |
| 6 | Dividenti | 0 | 2 | 2 | 8 | 9 | 111 | 130 | Divident | 4 |
| 7 | Tarifa sherbimesh | 224 | 587 | 965 | 1,329 | 1,953 | 2,266 | 2,652 | Services | 5 |
| 8 | Te tjera dhe interesa | 528 | 691 | 838 | 1,151 | 1,809 | 4,077 | 4,245 | Other/not allocated | 6 |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **24,018** | **56,335** | **87,919** | **117,911** | **151,047** | **182,707** | **210,970** | **TOTAL EXPENDITURE** | **I.** |
| **I.** | **Shpenzime Korrente** | **22,354** | **49,492** | **73,592** | **100,071** | **127,548** | **153,776** | **179,260** | **Current Expenditures** | I.1 |
| **I.1** | **Personeli** | **5,537** | **11,099** | **16,661** | **22,365** | **28,133** | **33,768** | **39,607** | **Personnel expenditures** | **1** |
| 1 | Paga | 4,773 | 9,573 | 14,376 | 19,318 | 24,280 | 29,167 | 34,256 | Wages | 2 |
| 2 | Kontributi per Sigurime Shoqerore | 764 | 1,526 | 2,285 | 3,047 | 3,853 | 4,601 | 5,351 | Social insurance contributions | 3 |
| 3 | Politikat e reja pagash | | | | | | | | Of which; Contingency | |
| **I.2** | **Interesat** | **2,571** | **6,556** | **9,345** | **11,483** | **16,302** | **19,977** | **22,793** | **Interest** | **I.2** |
| 1 | Te Brendshme | 2,376 | 5,960 | 8,537 | 10,122 | 14,485 | 17,770 | 20,419 | Domestic | 1 |
| 2 | Te Huaja | 195 | 596 | 808 | 1,361 | 1,817 | 2,207 | 2,374 | Foreign | 2 |
| **I.3** | **Shpenzime Operative Mirembajtje** | **2,583** | **7,271** | **9,816** | **12,901** | **15,739** | **18,526** | **21,313** | **Operational & Maintenance** | **I.3** |
| **I.4** | **Subvencionet** | **86** | **233** | **297** | **405** | **503** | **783** | **906** | **Subsidies** | **I.4** |
| | | | | | | | | | | **I.5** |
| **I.5** | **Shpenzime per Sig.Sociale dhe te tjera** | **8,288** | **17,523** | **27,062** | **36,868** | **46,461** | **56,494** | **66,644** | **Social insurance outlays** | **1.5** |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 6,456 | 13,163 | 20,335 | 27,674 | 34,857 | 42,453 | 50,183 | Social insurance | 1 |
| 2 | Sigurime Shendetsore | 1,832 | 4,160 | 6,527 | 8,994 | 11,404 | 13,841 | 16,261 | Health insurance | 2 |
| 3 | Shpenzime per kompensime ne vlere te pronarve | | 200 | 200 | 200 | 200 | 200 | 200 | Property Compensation | |
| **I.6** | **Shpenzime per Buxhetin Lokal** | **1,362** | **3,238** | **5,130** | **8,102** | **10,948** | **13,084** | **15,278** | **Local Budget** | **I.6** |
| **I.7** | **Shpenzime te tjera sociale** | **1,927** | **3,572** | **5,281** | **7,947** | **9,462** | **11,144** | **12,719** | **Other expenditures** | **I.7** |
| 1 | Pagesa e Papunesise | 71 | 148 | 232 | 321 | 410 | 500 | 589 | Unemployment insurance benefits | 1 |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 1,406 | 2,924 | 4,549 | 6,126 | 7,552 | 9,144 | 10,630 | Social assistance | 2 |
| 3 | Kompensim per ish te perndjekurit politike | 450 | 500 | 500 | 1,500 | 1500 | 1,500 | 1,500 | Compensation for ex political prisoners | 3 |
| **III.** | **Shpenzime Kapitale** | **1,664** | **6,843** | **14,327** | **17,840** | **23,499** | **28,931** | **31,710** | **Capital expenditures** | **III.** |
| 1 | Financimi Brendshem | 445 | 3,800 | 8,895 | 11,500 | 13,709 | 15,596 | 17,231 | Domestically financing | 1 |
| 2 | Financimi Huaj | 1,219 | 3,043 | 5,432 | 6,340 | 9,790 | 13,335 | 14,479 | Foreign financed | 2 |
| **IV** | **DEFIÇITI** | **1,713** | **-7,058** | **-9,571** | **-11,597** | **-17,885** | **-21,133** | **-21,044** | **Deficit** | **IV** |
| **IV.1** | **FINANCIMI DEFIÇITIT** | **-1,713** | **7,058** | **9,571** | **11,597** | **17,885** | **21,133** | **21,044** | **Deficit Financing** | **IV.1** |
| **IV.2** | **Brendshem** | **-2,223** | **5,110** | **5,837** | **8,352** | **12,086** | **12,810** | **12,020** | **Domestic** | **IV.2** |
| | Te ardhura nga privatizimi | 330 | 373 | 578 | 592 | 607 | 652 | 702 | Privatization receipts | |
| | Hua-marrje e brendeshme | 2,256 | 5,068 | 8,273 | 12,043 | 13,604 | 14,663 | 14,045 | Domestic Borrowing | |
| | Huamarje e brendshme nacionale nga te cilat: | 2,215 | 5,028 | 8,231 | 12,006 | 13,568 | 14,628 | 13,991 | | |
| | Huamarje e brendshme vendori | 41 | 40 | 42 | 37 | 36 | 35 | 54 | | |
| | Te tjera nga të cilat: | -4,809 | -331 | -3,014 | -4,283 | -2,125 | -2,505 | -2,727 | Other | |
| | Depozite e Qeverise ne Banken e Shqiperise | -3,531 | -778 | -3,280 | -4,105 | -3,347 | -3,613 | -4,491 | Government deposit at the BoA | |
| | Te tjera | -1,275 | 448 | 267 | -179 | 1,221 | 1,109 | 1,764 | | |
| | Depozite e Sig.Shoqerore dhe Shendetesore | -3,117 | -2,434 | -2,588 | -3,803 | -4,299 | -3,482 | -3,284 | Health and Social Security Deposit | |
| | Mjete ne ruajtje | -75 | 1,361 | 2,558 | 2,472 | 2,739 | 2,577 | 2,577 | | |
| | Principali i nenhuase (Bashkia Tirane=47.3 mln leke) | 251 | 251 | 251 | 332 | 660 | 1,015 | 1,089 | The amount of the Loan | |
| | Detyrim ndaj ISSH | -134 | 707 | 449 | -88 | 722 | 838 | 1,018 | Debt toward H&S Security | |
| | Te tjera (detyrime te perkohshme) | 1,800 | 563 | -403 | 908 | 1,399 | 161 | 364 | Other (temporary debts) | |
| | **I Huaj** | **510** | **1,948** | **3,734** | **3,245** | **5,799** | **8,323** | **9,024** | **Foreign** | |
| | Hua afatgjate(e marre) | 547 | 3,515 | 6,324 | 8,452 | 11,700 | 16,097 | 16,515 | Long-term Loan(Drawings) | |
| | *nga e cila nenhua* | 53 | 477 | 738 | 750 | 949 | 946 | 876 | | |
| | Ndryshimi i gjendjes se arkes* | 326 | -829 | -1,468 | -2,451 | -2,221 | -2,948 | -2,333 | Chang. of stat. Account* | |
| | Ripagesat | -363 | -738 | -1,122 | -2,756 | -3,680 | -4,826 | -5,158 | Repayments | |

Burimi: Ministria e Financave Source: Ministry of Finance

* *"Ndryshimi i gjendjes se arkes" perfaqeson ndryshimin ne Depozites se Financimeve te Huaja*

*"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit*

*Te dhena operative* *preliminary data*

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2012**
Table of investments 2012

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke( in million leks)*

| | Janar January | Shkurt Feb | Mars Mar | Prill Apr | Maj May | Qershor Jun | Korrik Jul | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Financim i brendshem** | **445** | **3,800** | **8,895** | **11,500** | **13,709** | **15,596** | **17,231** | **Domestic financing** |
| *Ne %* | *26.74* | *55.53* | *62.09* | *64.46* | *58.34* | *53.91* | *54.34* | *In %* |
| **Financim i huaj** | **1,219** | **3,043** | **5,432** | **6,340** | **9,790** | **13,335** | **14,479** | **Foreign financing** |
| *Ne %* | *73.26* | *44.47* | *37.91* | *35.54* | *41.66* | *46.09* | *45.66* | *In %* |
| **Totali *** | **1,664** | **6,843** | **14,327** | **17,840** | **23,499** | **28,931** | **31,710** | **Total** |
| *Ne %* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *In %* |

Burimi: Ministria e Financave Source: Ministry of Finance

*Tek Totali nuk eshte perdfshire zeri - Shpronesime -

Tab - 6

**TE ARDHURAT NGA ZYRAT E DOGANAVE 2012**
**REVENUES FROM CUSTOMS OFFICE 2012**

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke( in million leks)*

| | Janar January | Shkurt Feb | Mars Mar | Prill April | Maj May | Qershor June | Korrik July | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Takse doganore | 412 | 847 | 1,347 | 1,773 | 2,306 | 2,872 | 3,443 | Customs Duties |
| TVSH | 5,847 | 12,292 | 20,318 | 27,362 | 35,124 | 43,019 | 51,125 | V.A.T |
| Akcize | 1,102 | 2,609 | 4,401 | 5,772 | 7,409 | 9,505 | 11,743 | Excises |
| Te tjera | 339 | 731 | 1,274 | 1,879 | 2,355 | 2,742 | 3,109 | Others |
| **Renta Minerare** | | | **1,253** | **1,859** | **2,329** | **2,667** | **3,023** | |
| **TOTALI I DOGANAVE** | **7,700** | **16,479** | **27,340** | **36,786** | **47,194** | **58,138** | **69,420** | **Total from customs office** |
| **TE ARDHURAT TATIMORE NGA ZYRAT E TATIMEVE** | | | | | | | | |
| **TAX REVENUES FROM TAX OFFICE** | | | | | | | | |
| TVSH | 2,580 | 4,753 | 6,166 | 8,010 | 10,038 | 11,712 | 13,442 | V.A.T |
| Akciza | 1,215 | 2,386 | 3,247 | 4,591 | 6,133 | 7,619 | 9,370 | Excises |
